



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

---

Nr. 196/P Prot

Shkodër, më 30.12.2022

**KONTRATË SIPERMARRJE SHËRBIMI NR.4**  
**REF-64315-07-07-2020**

**“SHËRBIMI I PASTRIMIT PËR BASHKINË SHKODËR ZONA LINDORE”**

**BASHKIA SHKODËR**  
**DHJETOR 2022**

**KONTRATË SIPERMARRJE SHËRBIMI NR.4**  
**REF-64315-07-07-2020**

**“SHËRBIMI I PASTRIMIT PËR BASHKINË SHKODËR ZONA LINDORE”**

E lidhur sot me datë \_\_\_\_\_, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z.Bardh Spahia** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

**Dhe** Operatorit ekonomik **”Alko-Impex General Construcion”sh.p.k.** regjistruar ne regjistrin fillestar me nr.CN-202267-01-09 dhe leje profesionale te shoqerise kodi III.2.B nr.LN-1163-03-2016 date 10.03.2016 me vlefshmeri te lejes pa afat leshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit,Tregtise dhe Siper marrjes me seli te shoqerise:Rruga Reshit Petrela, Kompleksi Usluga-Tirane me NUIS K 91326028 I, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **z.Arber Abazi** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **”Kontraktuesi”**.

**Neni 1**

**Baza ligjore**

- ✓ Kodi Civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, të ndryshuar,
- ✓ Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 52 të ligjit.
- ✓ VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 59, nenit 60, pika 1/a) e nenit 64, nenit 65 të kreu VI.
- ✓ Ligji nr. 48/2014 ”Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar
- ✓ VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar
- ✓ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane”
- ✓ Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “për largimin publik të mbeturinave”
- ✓ VKB nr. 83, datë 26.12.2017 “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të ngurta Urbane Bashkia Shkodër 2017-2022”

**Neni 2**

**Përkufizime**



*Clau ceplos e Shkodër*

## 2.1 Kontrata

- “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- “**Kontratë**”, nënkupton marrëveshjen e shkruar, e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik. Ajo përbëhet nga:
- “**Çmim kontratë**” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- “**Objekt i kontratës**” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- “**Shërbime**” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- “**Termat e References**” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- “**Specifikimet teknike**” siç janë paraqitur në dokumentet e tenderit dhe në Kontratë dhe çdo shtesë apo modifikim i Specifikimeve në përputhje me Kontratën. Ky dokument specifikon Shërbimin.
- “**Preventivi**” quhen vëllimet e punës të plotësuara me cmime, pjesë perberese e kontratës.

## 2.2 Palët dhe personat

- “**Palë**” nënkupton Autoriteti Kontraktor ose Kontraktuesi, sipas kontekstit.
- “**Autoritet Kontraktor**”, nënkupton Bashkinë Shkodër, një entitet shtetëror i autorizuar me ligj për të kryer procedurat e prokurimit, e cila përcakton kritere dhe kërkesa për përbushjen e planifikimit të saj për realizimin e blerjes së shërbimeve dhe të mirave në interes të interesit publik.
- “**Kontraktuesi**” nënkupton personin(at) të quajtur Kontraktues të pranuar nga Autoriteti Kontraktor dhe pasardhësi juridik me këtë titull për këtë person.
- “**Monitorues i Shërbimit**” nënkupton personin kompetent të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, i cili është përgjegjës për supervizimin e performancës së Shërbimit të pastrimit dhe që asiston administrimin e Kontratës.
- “**Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit**” nënkupton personin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër si përfaqësues i Kontraktuesit, i cili është përgjegjës për performancën e shërbimit të pastrimit sipas kontratës.

## 2.3 Datat, Periudhat dhe Përbushja

- “**Data e Fillimit**” nënkupton datën e përcaktuar si e tille për fillimin e Shërbimit.
- “**Koha e përbushjes**” nënkupton kohën për përbushjen e Shërbimeve.
- “**Ditë**” nënkupton një ditë kalendarike dhe “vit” nënkupton 365 ditë.

## 2.4 Paratë dhe Pagesat

- “**Vlera totale e kontratës**”, nënkupton vlerën e pranuar nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe përbushjen e Shërbimit.



- **“Çmim kontratë”**, nënkupton vlerën për t’u paguar nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe përmbushje nga ana e Kontraktuesit të shërbimeve dhe përmbushjes së të gjitha detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të lidhura me këtë Kontratë.
- **“Certifikata e pagesës – situacioni”**, nënkupton dokumentin e evidencave faktike të shërbimit të kryer, në përputhje me zërat e specifikuar në preventiv, dhe të certifikuara me procesverbalet ditore, të hartuara nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër.
- **“Procesverbalet – Deklaratat”**, nënkupton dokumentet kontraktuale të hartuara nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër, për përshkrimin e gjetjeve të verifikuara gjatë kontrolleve të ushtruara në terren, të cilat kanë qëllim të pasqyrojnë dhe certifikojnë Shërbimin e kryer, pakryer dhe në proces, në mënyrë që të përcaktohen përgjegjësitë kontraktuale dhe të përlllogariten penalitetet e mundshme dhe gjodat për Kontraktuesin në përputhje me termat e kësaj Kontratë. Procesverbalet do të pershkruajnë gjithashtu problematikat e hasura gjatë inspektimeve.
- **“Procesverbalet”** do të përdoren si mbështetje për të certifikuar pagesën për Kontraktuesin.

## 2.5 Shërbimet dhe Përkufizime të tjera

- **“Shërbimet – Objekti i Kontratës”** nënkupton të gjitha Shërbimet që do të ofrojnë Kontraktuesi sipas kriterëve dhe termave të percaktuara në këtë Kontratë.
- **“Mbetje të ngurta Urbane”** nënkupton të gjitha materialet organike dhe inorganike që vijnë nga konsumi i Konsumatoreve.
- **“Edukim publik ambiental”**, nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve apo banorëve të qytetit me qëllim përpunimin, transportin, largimin ose aspektet e tjera që lidhen me mbajtjen pastër të ambjentit.
- **“Zonë e kontratës”** quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë e mbi të cilët ushtron juridiksionin e kompetencë institucioni Bashkia Shkodër. Kjo hartë është pjesë përbërëse e kësaj kontratë, ku Kontraktuesi si është i detyruar të sigurojë përmbushjen e shërbimeve të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbeturinave dhe hedhurinave të konsumatorëve ekzistues, si dhe konsumatorëve të tjerë që mund të shtohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.
- **“Mbeturina të rrezikshme”**, nënkuptojnë mbeturinat e dëmshme ose toksike, që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e personit, sjellin pasoja ekologjike dhe administrohen me ligje të veçanta”.
- **“Pikë grumbullimi i mbeturinave (PGM)”** nënkupton hapësirën në të cilën do të kryhet shërbimi i heqjes së mbeturinave nga kontenierët dhe zona përreth kontenierëve, siç është përcaktuar në hartë dhe në specifikimet teknike bashkëngjitur dokumenteve të tenderit.

### Neni 3

#### Objekti i kontratës

3.1 Objekt i kësaj kontratë është shërbimi me objekt: **“Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore”** në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në

dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi-Alko-Impex General Construcion sh.p.k**, pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit. Kontraktuesi pranon të gjitha termat e procedurës së prokurimit me firmosjen e kësaj Kontratë.

#### Neni 4

##### Afati i kontratës – Data Fillimit


4.1. Kontrata nr.4 do të realizohet nga data **01.01.2023 deri me date 09.10.2023**.

#### Neni 5

##### Vlera e kontratës

- 5.1 Kontraktuesi merr përsiper të kryejë të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere prej **12,062,493.00**(Dymbëdhjetemilion e gjashtedhjetë e dymije e katerqind e nentëdhjetë e tre) leke pa tvsh dhe **14,474,991.60** (Katermbëdhjetemilion e katerqind e shtatëdhjetë e katermije e nentëqind e nentëdhjetë e një pike gjashtedhjetë)leke me tvsh.
- 5.2 Financimi i kontratës realizohet nga Buxheti i Bashkisë Shkodër.
- 5.3 Çmimet e përfshira në Kontratë, nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga Kontraktuesi në ofertën e tij fillestare.
- 5.4 Volumet e shërbimit brenda të njëjtit zë shërbimi, mund të ndryshojnë sipas nevojave por totali nuk duhet të kalojë vlerën vjetore të pritshme.
- 5.5 Çmimet për njësi janë percaktuar në Formularin e Cmimit të Ofertës si me poshte:

| Nr | Analize | Pershkrimi i punes                                 | Njesia | Preventiv<br>( Vlera totale e kontrates ) |          |                      |
|----|---------|--|--------|---|----------|----------------------|
|    |         |  |        | Sasia                                     | Cmimi    | Vlera                |
| 1  | VKM     | Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetjeje urbane | ton    | 5,897.00                                  | 1,035.00 | 6,103,395.00         |
| 2  | VKM     | Menaxhim dhe mirëmbajtje Kazanësh                  | cope   | 277.00                                    | 3,000.00 | 831,000.00           |
| 3  | VKM     | Depozitim në Landfilli I mbetje urbane             | ton    | 5,897.00                                  | 863.00   | 5,089,111.00         |
| 4  |         | <b>Shuma</b>                                       |        |   |          | <b>12,023,506.00</b> |
| 5  |         | TVSH 20%   |        |   |          | 2,404,701.20         |
| 6  |         | <b>Shuma I me tvsh (sipas manualit)</b>            |        |   |          | <b>14,428,207.20</b> |
| 7  | An-1    | Dizinfektim PGM                                    | kg     | 2999                                      | 13       | 38,987.00            |
| 8  |         | TVSH 20%   |        |   |          | 7,797.40             |
| 9  |         | Shuma II me TVSH                                   |        |   |          | 46,784.40            |
| 10 |         | <b>TOTALI PA TVSH</b>                              |        |   |          | <b>12,062,493.00</b> |
| 11 |         | <b>TOTALI ME TVSH</b>                              |        |   |          | <b>14,474,991.60</b> |





## Neni 6 Qëllimi

- 6.1 Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës së hapur.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë, parashikon së dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj Kontratë.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik, janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i vetëm disa prej dispozitave këtu, nuk mohon në asnjë rast zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e Palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të prevalojnë mbi KPK.

## Neni 7 Gjuha e kontratës

- 7.1 Gjuha e kontratës është gjuha Shqip.

## Neni 8 Hartimi i Kontratës


- 8.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e Kontratës midis Palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 8.2 Ekzistenca e Kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumenteve të Kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis Palëve si dhe dokumenteve të listuara në Nenin 2.

## Neni 9 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Proçesverbaleve

- 9.1 Autortiteti Kontraktues Bashkia Shkodër, mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme Kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 9.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 9.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues Bashkinë Shkodër, të inspektojë llogaritë dhe proçesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër.

## Neni 10 Informacioni konfidencial

- 10.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me Kontratën.



## Neni 11

### Prona intelektuale

- 11.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontratës do të bëhen pronësi e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, Kontraktuesi, pas përmbushjes të Kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pergatitura nga Kontraktuesi gjatë Kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me Kontratën pa autorizimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër.
- 11.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Shkodër, nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas Kontratës.
- 11.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues Bashkisë Shkodër në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale, të shkaktuar nga zbatimi i Kontratës ose nga përdorimi i shërbimeve të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër, të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## Neni 12

### Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit

- 12.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi të gjithat detyrimet siç përcaktohet në këto kushte dhe në Specifikimet Teknike „Specifikimet teknike Zona Perendimore“ me të gjitha përpyekjet, efçente dhe qasje ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 12.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta pune.
- 12.3 Nëse Kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues Bashkisë Shkodër, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes së mire të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 12.4 Nëse Kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër .

## Neni 13

### Detyrimet e veçanta të kontraktuesit

- 13.1 Kontraktuesi pas nënshkrimit të Kontratës ka për detyrë të kryejë Shërbimin e pastrimit në zonën e përcaktuar në Kontratë. Këto shërbime kryhen bazuar e sipas zërave të shërbimit të përcaktuar në Preventiv dhe në përputhje me "Specifikimet teknike", si dhe në propozimet teknike të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertën e tij dhe të pranuar nga Autoriteti

Kontraktues.

- 13.2 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e kryerjes së shërbimeve të paraqesë të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e listuara në “Specifikimet Teknike”.
- 13.3 Në rast se mjetet, makineritë dhe pajisjet nuk janë në gjendje pune dhe shërbimi nuk ofrohet me këto mjete, kontraktuesi penalizohet.
- 13.4 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e kryerjes së shërbimeve të punësojë dhe të sigurojë në përputhje me legjislacionin shqiptar të gjithë punonjësit e tij, sipas përcaktimeve në “Specifikimet Teknike”.
- 13.5 Përfaqësuesit e Kontraktuesit, të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit të përditshëm të performancës së Shërbimeve, duhet të jenë të autorizuar zyrtarisht nga Drejtuesi Teknik i Shërbimit të Pastrimit ose nga Administratori i Kontraktuesit.
- 13.6 Nëse Kontraktuesi duhet të ndërpresë zbatimin e shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar ose në një zonë të caktuar, për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve) ndërprerja e Shërbimit ose rregullimet e mundshme duhet të njoftohen zyrtarisht dhe të kenë miratimin e Autoritetit Kontraktor, Bashkinë Shkodër, që konsideron të pranueshme këtë ndërprerje apo ndryshim.
- 13.7 Drejtori Teknik i Shërbimit të Pastrimit, është personi përgjegjës i cili autorizohet të nënshkruajë të gjitha procesverbalet dhe situacionet ditore, javore, mujore, baza për t’u përdorur për përparimet e certifikatës së pagesës (situacioneve), dhe që janë të mbajtura nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër.
- 13.8 Kontraktuesi është i detyruar të disponojë në çdo kohë e në gatishmëri të plotë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara për realizimin e Shërbimeve janë në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të paisjeve, është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika grumbullimi, Kontraktuesi mund të ndryshojë një pjesë të pajisjeve vetëm pas miratimit nga Bashkia Shkodër.
- 13.9 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë persipër në përputhje të plote me dokumentat e tenderit, metodologjise së punës si edhe specifikimeve teknike dhe grafikun e shërbimit pjese perberese e kesaj kontrate.

#### Neni 14\*

#### Raportimi

- 14.1 Kontraktuesi është i detyruar të raportojë përmes dorëzimit të raportit vjetor, në të cilat duhet të përshkruajë një përmbledhje vjetore të pagesave sipas preventivit, listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për proceset e shërbimeve. Raporti duhet të përmbajë numrin e konteniereve të larë sipas planit të përcaktuar, numrin e konteniereve në operim, numrin e konteniereve të rinj të ofruar dhe numrin e konteniereve në mirëmbajtje në fund të vitit. Raporti duhet të përmbajë emrat ashtu edhe emërtesat e personelit mbikqyrës, të vendosur nga Kontraktuesi; një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve, nëse ka, të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së Shërbimit si dhe një përmbledhje të Shërbimit të realizuar vjetor. Raporti duhet të dorëzohet përmes zyrës së protokollit në format tabelar dhe dokumente të printuara dhe të firmosura, si dhe në format elektronik në adresën zyrtare elektronike të Autoritetit





Kontraktor [sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al](mailto:sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al)

- 14.2 Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Shkodër, 5 (pesë) kopje të raportit vjetor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i çdo viti kalendarik, të shoqëruar me situacionin e fundit vjetor të shërbimit, procesverbalet dhe statusit financiar.
- 14.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë rakordimin për situacionin e muajit paraardhës (procesverbalet e performancës së shërbimit, mos performancës së shërbimit dhe nën performancës). Kontraktuesi pas rakordimit brenda 5 (pesë) ditëve dorëzon Autoritetit kontraktor situacionin dhe faturën tatimore elektronike për situacionin mujor të rakorduar sipas volumit të shërbimeve të kryera për muajin paraardhës dhe dokumentacionin përkatës. Situacionet duhet të firmosen nga të dyja Palët në 6 (gjashtë) kopje, dy prej të cilave i jepen Kontraktuesit.
- 14.4 Fatura nuk bëhet në asnjë rast përpara rakordimit dhe nënshkrimit të situacionit. Kërkesa për pagesë duhet të shoqërohet me faturën tatimore elektronike dhe situacionin e rakorduar për performancën e Shërbimit për muajin paraardhës. Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër përmes postës, ose përmes dorëzimit pranë sekretarisë/zyrës së protokollit të Autoritetit Kontraktor ndersa fatura tatimore në format elektronik.
- 14.5 Për zërin e Shërbimit "Depozitim në Landfill i mbetjeve urbane", bashkangjitur aplikimit për pagesë, duhet të jetë pasqyra analitike e volumit të mbeturinave të transportuara gjatë muajit. Pasqyra analitike duhet të ketë bashkëngjitur të gjitha "flet peshoret elektronike" të marra për çdo depozitim të realizuar me informacionin e numrit të kamionit, dites, orës së peshimit në hyrje dhe dalje dhe peshes neto.
- 14.6 Bashkia Shkodër duhet të kryejë pagesat për Shërbimet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e dorëzimit të faturës. Mosdorëzimi/mosrakordimi i dokumentave i jep të drejtë Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, të mos e paguajë Kontraktuesin deri sa ky i fundit të paraqesë faturën me bashkëlidhjet e kërkuara.

## Neni 15


### Specifikime dhe Skicime

- 15.1 Nëse Kontrata për qëllime të përmbushjes së objektit të saj kërkon shërbime skicimi, kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet e kërkuara duke përdorur sisteme të përparura e të pranuara, të njohura në përgjithësi e të pranueshme për Autoritetin Kontraktues Bashkinë Shkodër dhe duhet, kur është e mundur, të përdore standardet më të fundit.
- 15.2 Nëse Kontrata për qëllime të përmbushjes së objektit të saj kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjësore përsa i përket hapjes së konkurrencës në procesin e prokurimit.

### 15.3 Specifikimet teknike

#### 1.1 Volumet e punimeve

Në zonën Lindore bëjnë pjesë NJA Prathina, Postribe, Shale, Guri Zi, Shosh. Kjo zonë ka një popullsi prej 42967 banorë (sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë). Zona ka karakter rural.



Në total në zone gjenerohen 21,54 ton/ditë mbetje të ngurta urbane, ose 7863 ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë viti, të cilat duhet të grumbullohen dhe transportohen në landfillin e Bushatit çdo ditë të javës.

Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në terren nga rreth 350 kontenierë metalikë me kapacitet 1,100 litra (1.1m<sup>3</sup>) të shtrirë në të gjitha njësitë administrative. Këto kontenierë janë pronë e bashkisë.

### 1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar.
- b. Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.
- c. Pastrim të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi.
- d. Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.
- e. Klorifikimi i zonës së kazanëve, sipas normativave.
- f. Larja e kazaneve sipas nje grafiku te miratuar
- g. Transportin e mbeturinave në vend e depozitimit të tyre.

### 1.3 Frekuencat e grumbullimit

- a. Në zonën Lindore shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet sipas grafikëve të përcaktuar. Oraret e grumbullimit do të jenë ditën nga ora 06.00 deri në orën 12.00.
- b. Për zonën lindore, parashikohen të përdoren 2 mjete teknologjike 10 ton dhe 1 mjet teknologjik 5 ton, të cilët do të ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve 2.5 herë në javë/1 turn në ditë për të gjithë zonën (1 mjet teknologjik 10 ton ofron shërbimin vetëm në NJA Rrethinat – Landfilli i Bushatit; 1 mjet teknologjik 10 ton ofron shërbimin në NJA Postribë – NJA Guri i Zi - Landfilli i Bushatit; mjeti teknologjik 5ton ofron shërbimin në NJA Pult – NJA Shalë – NJA Shosh – Landfilli i Bushatit dhe në rrugicat e ngushta ku nuk mund të hyjë mjeti 10ton).

| Përbërja   | Infrastruktura  |            | Të dhënat teknike  |               |
|--|---|------------|--------------------|---------------|
|  | Mjetet  | Kontenierë | Norma e gjenerimit | Frekuenca     |
| <b>Njësitë e Zonës Lindore</b>                     |   |            |                    |               |
| Rrethinat, Postribë, Shalë, Pult, Shosh, Guri i Zi | 3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjeti i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta) | Total 350  | 0.3 kg/banorë/ditë | 2.5 herë/javë |

### 1.4 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve



a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .

b. Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

### 1.5 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.

b. Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.


c. Kontraktuesi duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-12.00 . Përfaqësues të kontraktuesit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 1 ore nga marrja e njoftimit.

d. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

e. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

f. N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rena gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

g. Përdorimi i uniformave dhe masave të sigurimit teknik për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyruesëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.







## 1.6 Mjetet dhe pajisjet


Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

### Kërkesa për mjete .

| Nr | Emertimi I mjetit                          | Kapaciteti | Sasi (copë) |
|----|--|------------|-------------|
| 1  | Mjete teknologjike pastrimi                | 10 ton     | 2           |
| 2  | Mjete teknologjike pastrimi                | 5 ton      | 1           |
| 3  | Mjete teknologjike pastrimi <b>rezerve</b> | 5-10 ton   | 1           |
| 4  | Mjet me cistern per larje kontanieresh     |            | 1           |

| Lloji i mjetit                                  | Mjet teknologjik transportues (kompaktor)  |
|---|--|
| Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit) | 10ton/5ton<br>  |
| Raporti i Kompaktimit                           | 1:4 – 1:6  |
| Kapja e mjetit në pjesën fundore                | Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m <sup>3</sup> )<br> |
| Rrotat e mjetit                                 | Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lehtë në territore malore dhe të mbuluara me borë   |
| Viti i Prodhimit                                | Jo më poshtë se viti 2005  |





|                             |  |
|-----------------------------|--|
| Nëse mjete është i përdorur | Të këtë bërë jo më shumë se 150,000 km |
| Lënda djegëse               | Diesel/benzine                         |
| Marshi                      | Manual/automatike                      |
| Klasa e shkarkimit          | Euro 5                                 |

### 1.7 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.

d. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

e. Autoriteti Kontraktor në plan ka parashikuar një grafik të lëvizjes së mjeteve, por Kontraktuesi duhet të mundësojë një hartë të rrugës më eficiente që duhet të ndjek mjete për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe kalendarin përkatës.


f. Kontraktuesi do të realizojë instalimin e sistemit të GPS në të gjitha mjetet teknologjike e jo teknologjike. Autoritet kontraktor do lidhet me këtë system nga Kontraktuesi.

Kontraktuesi do mundësojë nëpërmjet serverit qendror të sistemit GPS realizimin e sistemit të monitorimit edhe nga Autoriteti Kontraktor. Kjo do të mundësojë një raportim ditor, javor dhe mujor të lëvizjes të të gjitha mjeteve, që Autoriteti Kontraktor duhet t'ia bashkangjisë raporteve të monitorimit në terren. Do të monitorojë të gjitha lëvizjet e mjeteve teknologjike në zonat përkatëse dhe do të ketë mundësi kontrolli më të mirë në lidhje me rrugën e mjeteve, ndalesave të tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazen e kontenerëve dhe kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sistemi I GPS nuk duhet të shkëputet nga lidhja me Autoritetin Kontraktor për asnjë moment si dhe nuk duhet të shkëputet nga lidhja me mjetin. Nqs rezulton sistemi I fikur tek Autoriteti Kontraktor apo dhe tek mjetet, kontraktuesi do penalizohet.

### 1.7 Kushtet teknike për mjetet e transportit

a. Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjëndje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.


b. Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenerët që do të përdoren në NjA.



- c. Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash.
- d. Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrenë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.
- e. Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arësye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h.
- f. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjisllacionit në fuqi.
- g. Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë.
- h. Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.
- i. Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 dhe 5 ton)
- j. Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e makinave teknologjike dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.
- k. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- l. Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.
- m. Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenierëve të mbledhur.
- n. Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasinë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.
- o. Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

## 1.8 Personeli

- a. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.
- b. Kushtet e punës duhet të jenë në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Kontraktuesi është përgjegjës për marrjen e të gjitha masave për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve.



c. Personeli i kontraktuesit duhet të jetë gjithnjë i pajisur me doreza dhe rroba të përshtatshme pune që kanë shenjat dalluese të shoqërisë si edhe me sinjalistikën e duhur për sigurinë e punës gjatë natës.

d. Kazalet duhet të trajtohen me kujdes nga personeli i kontraktuesit, të boshatisen krejtësisht dhe të vendosen ashtu siç duhet në vendet e caktuara për ta. **Riparimi i kazaletëve të dëmtuar është në ngarkim të shoqërisë.**

e. Ekipi i monitorimit i Bashkisë ka kompetencën e dhënies së udhëzimeve drejtuesit të personelit të kontraktuesit.

f. Shoqëria është përgjegjëse për trajnimin dhe arsimimin e personelit të saj në drejtim të praktikave të mira të punës. Kjo përfshin edhe ndalimin e futjes së mbetjeve në sistemin e grumbullimit të ujit.

- Kërkesa për puntori

| Nr | Specialiteti                                 | Njesi   | Sasi |
|----|--|---------|------|
| 1  | Shofere                                      | persona | 3    |
| 2  | Puntor makine për grumbullim mbeturina       | persona | 9    |
| 3  | Drejtor teknik për kontratën                 | persona | 1    |
| 4  | Personi I zyrës së kontaktit                 | Persona | 1    |
| 5  | Specialist , monitorues terreni për cdo NJ.A | Persona | 4    |
| 6  | Shuma  |         | 18   |


### 1.9 Skenaret e levizjes së mjeteve për grumbullimin e mbetjeve urbane.

**Zona Lindore (Fshati Mes – NJA Postribë – NJA Guri i Zi - landfilli Bushati)**

1 mjet 10 ton - gjatësia e rrugës 92km (një kah)










**Zona Lindore (NJA Rrethinat – landfilli Bushati)**

1 mjet 10 ton – gjatësia e rrugës 52km (një kah)






Zona Lindore - rrugëtimi II (Fshati Mes – NJA Rrethinat – Landfill Bushati)

**Zona Lindore (Fshati Mes – NJA Pult – NJA Shosh – NJA Shalë - landfilli Bushati)**


1 mjet 5 ton – gjatësia e rrugës 92km (një kah)











**Tabela përmbledhëse për rrëgutimet në Zonën Lindore**

| ZONA LINDORE                     |                             | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Pren |
|----------------------------------|-----------------------------|--------|---------|-----------|---------|--------|
| <b>Rrugëtimi I</b>               | <b>Postribë - Guri i Zi</b> |        |         |           |         |        |
| <i>Nisja</i>                     | <b>Fshati Mes Postribë</b>  |        |         |           |         |        |
| <i>Pika fundore</i>              | <b>Landfill Bushatit</b>    |        |         |           |         |        |
| <i>Gjatësia e rrugës (1 kah)</i> | <b>92km</b>                 |        |         |           |         |        |
| <i>Kohëzgjatja</i>               | <b>7h55'</b>                |        |         |           |         |        |
| <i>Mjeti - I</i>                 | <b>1 mjet 10ton</b>         |        |         |           |         |        |
| <b>Rrugëtimi II</b>              | <b>Rrethinat</b>            |        |         |           |         |        |
| <i>Nisja</i>                     | <b>Fshati Mes Postribë</b>  |        |         |           |         |        |
| <i>Pika fundore</i>              | <b>Landfill Bushatit</b>    |        |         |           |         |        |
| <i>Gjatësia e rrugës (1 kah)</i> | <b>52km</b>                 |        |         |           |         |        |
| <i>Kohëzgjatja</i>               | <b>3h08'</b>                |        |         |           |         |        |
| <i>Mjeti-II</i>                  | <b>1 mjet 10ton</b>         |        |         |           |         |        |
| <b>Rrugëtimi III</b>             | <b>Shalë-Pult-Shosh</b>     |        |         |           |         |        |
| <i>Nisja</i>                     | <b>Fshati Mes Postribë</b>  |        |         |           |         |        |
| <i>Pika fundore</i>              | <b>Landfill Bushatit</b>    |        |         |           |         |        |
| <i>Gjatësia e rrugës (1 kah)</i> | <b>92km</b>                 |        |         |           |         |        |
| <i>Kohëzgjatja</i>               | <b>9h35'</b>                |        |         |           |         |        |
| <i>Mjeti-III</i>                 | <b>1 mjet 5ton</b>          |        |         |           |         |        |

## 2. Dezifektimi i PGM

### 2.1 Volumet e punimeve

a. Duhet të bëhet dezifektimi i zonës perrëth kontanierëve, pas zbrazjes së çdo kontanieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

b. Frekuenca e dizifektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj-Shtator ( ditë merkure dhe shtune) , ndërsa periudhën tjetër te vitit 2 ( dy) here në muaj.

### 3. Menaxhim dhe mirembajtja kontanieresh.

Pronësia e kontanierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen ,menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### 3.1 Menaxhimi i kontanierëve:

a. Vendosja e kontanierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontanierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontanierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e kontanierëve.

b. Kontanierët do të identifikohen me një numër rendor dhe një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kontraktuesi duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontanierët.



c. Sipërmarrësi I shërbimit është I detyruar të zëvendësojë në mënyrë progressive 15% të kazanëve çdo vit kalendarik. Konkretisht do blihen 55 (pesëdhjetë e pesë) kazanë metalikë të xinguar 1100 litrash dhe do blihen në fund të çdo gjashtëmujori. Furnizimi dhe më pas ndarja do bëhet në marrëveshje me Autoritetin Kontraktor. Numri I kazanëve që do blihen do të jetë:

-Për gjashtëmujorin e parë të vitit do blihen nga 35 (tridhjetë e pesë) kazanë.

-Për gjashtëmujorin e dytë të vitit do blihen nga 20 (njëzet) kazanë.

Për mosrealizim të blerjeve të kazanëve sipas planit, Sipërmarrësit në fund të çdo gjashtëmujori në situacione, do ti ndalet vlera e kazanëve të pa blerë.

### 3.2 Mirëmbajtja e kontenierëve:

a. Kontenierët e dëmtuar duhet të rregullohen sistematikisht nga kontraktuesi. Kontraktuesi kanë për detyrë të monitorojnë rregullisht gjendjen fizike të kontenierëve, dhe të mbajnë një inventar për të gjithë kontenierët, të cilin duhet ta raportojë te Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme. Për të riparuar kontenierët, kontraktuesi duhet të ketë një mjet të veçantë për transportin e kontenierëve për t'i riparuar ato në ambjentet e kompanisë.

b. Kontraktuesi duhet të mbajnë një rezervë prej 10 (dhjetë) kontenierësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Dëmtimet e mundshme, të cilat riparohen mbrenda 5- ditëve të evidentimit, janë:

rrotat,

kapakët,

dorezat,

deformime të ndryshme të kontenierit.

lyerja e kontenierëve

c. Përsa kohë kontenierët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.


d. Kontraktuesi duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e përshtatshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe një oficinë të pajisur me mjetet dhe paisjet e nevojshme.

### 3.3 Larja e kontenierëve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 371 kontenierë të volumeve 1.1 m<sup>3</sup>/ brenda muajit ose mesatarisht 12 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

#### • Metodologjia

1. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
2. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.
3. Larja bëhet në pikat e grumbullimit nga mjeti që ka dhe cisternon me ujë.





- **Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për larjen e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.

2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.

3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

- **Mjetet dhe pajisjet**

1. Makine transportuese me cisterno uji për larjen minimalisht të 10 kontenierve në ditë.

2. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e kontenierëve.

#### **4. Vendi i depozitimit të mbetjeve**

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit.

Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të Ofertuesit mbi bazën e çmimit njësi aktual të depozitimit në Landfill-in e Bushatit

Nëse çmimi i depozitimit do të ndryshojë, atëherë ky ndryshim do të reflektohet në koston e këtij shërbimi në baze vjetore.

Mbetjet urbane të riciklueshme do të trajtohen nga vete Kontraktori, sipas nje marreveshje që do bëjë me bizneset.

#### **5. “Edukimi Publik Mjedisor”**

a. Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Kontraktori për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve ne burim, etj periudhës së kontratës.

b. Kontraktori duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Kontraktorit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambientit.

c. Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë Sipërmarrësi duhet të miratohet nga Autoriteti kontratues.

d. Buxheti që Sipërmarrësi duhet të shpenzojë për edukimin mjedisor, është i përfshirë në koston e zërit të shërbimit “Grumbullim, transport i mbetjeve urbane” (sipas llogaritjes së koston në bazë të VKM). Masa e buxhetit është 5% e vlerës së këtij zëri të shërbimit në preventiv


#### **6. Pajisja e punonjësve me uniforme.**

a- Kontraktori duhet të pajisë të gjithë punonjësit e vete me uniforme të njëjtë.

b- Uniforma duhet të ketë të stampuar siglën e Kontraktuesit, si dhe të Autoritetit Kontraktor. Kjo në dakortësi ndërmjet palëve.

c- Punonjësit duhet të pajisen me uniforme verore dhe dimërore, model i miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

d- Mbrenda tre muajve të fillimit të kontratës, të gjithë punonjësit duhet të jenë të pajisur me uniformën.





e-Nuk lejohet për asnje lloj arsye që punonjësit të mos kene të veshur uniformën e përcaktuar, në të kundërt, penalizohet.

## Neni 16

### Lejet dhe Licensat

16.2 Kontraktuesi ka përgjegjësi për sigurimin e lejeve, liçensave dhe autorizimeve sipas e në përputhje me kërkesat ligjore të Republikës së Shqipërisë, për të zbatuar Shërbimin, veç rastit kur Palët bien dakord ndryshe.

## Neni 17

### Heqja dhe zëvendësimi i personelit kryesor

17.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër, përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç propozohet në ofertën e Kontraktuesit.

17.2 Kontraktuesi zëvendëson çdo punonjës, nëse Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër evidenton se personi ka kryer veprime të kundërligjshme ose Autoriteti Kontraktues vlerëson se performanca e personelit është e pakënaqshme.

17.3 Nëse lind nevoja për zëvendësimin e një apo më shumë personave që bëjnë pjesë në personelin kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë që zëvendësuesi është me kualifikime ekuivalente ose më të mira. Kontraktuesi duhet të dorëzojë për miratim CV e zëvendësimit.

17.4 Kontraktuesi duhet të paguaje çdo kosto shtesë në rast të zëvendësimit të personelit të tij, me përjashtim të rasteve kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur si përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues, jashtë kontrollit të Kontraktuesit.

17.5 Kontraktuesi duhet të sigurojë që pagat e punonjësve të tij janë në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

17.6 Të gjithë drejtuesit e të gjitha llojeve të automjeteve dhe kamioneve të Kontraktuesit, duhet të jenë të kualifikuar për qëllimet e Shërbimit dhe duhet të kenë Leje të vlefshme drejtimi lëshuar nga Republika e Shqipërisë me kategorinë përkatëse. Kontraktuesi ka përgjegjësinë të ndalojë dhe kontrollojë konsumin e alkoolit përpara dhe gjatë oreve të punës, si për drejtuesit e mjeteve dhe punonjësve. Perfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor janë të lejuar të kontrollojnë në çdo orë të punës për nivelin e alkoolit të punonjësve të Kontraktuesit dhe në rastet e përsëritjes së praktikave të këqija të zbatojë pikën 2 të këtij neni.

17.7 Kontraktuesi duhet të fillojë kurse specializimi (trajnojë) për të gjithë punonjësit e tij që do të angazhohen në kryerjen e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave të ngurta, në mënyrë që të jenë në gjendje të dallojnë mbeturinat e rrezikshme, të infektuara dhe të papranueshme, të jenë të vemendshëm dhe të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe të ndjekin praktikat e mira.

17.8 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjithë punonjësit me uniforma sigurie dhe me shenja dalluese (badge) me emrat e Kontraktuesit dhe të Autoritetit Kontraktor.

17.9 Kontraktuesi nuk duhet të lejojë punonjësit e tij të përfitojnë, të nxisin, ose të kërkojnë pagesë shtesë nga operatorë privatë, ose publikë për largimin e mbeturinave urbane dhe jo urbane. Punonjësit e Kontraktuesit nuk do të lejohen të seleksionojnë mbetjet dhe të shesin materialet e ricikluara për interes të punës.

17.10 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjitha mjetet dhe paisjet me të gjitha karakteristikat dhe shenjat dalluese të Kontraktuesit ashtu siç përcaktohet në "Specifikimet Teknike".

17.11 Kontraktuesi është i detyruar të caktojë një Drejtor Teknik për këtë Kontratë. Drejtuesi teknik i shërbimit është personi që Kontraktuesi ka propozuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik për Shërbimin është: **Z. Nazmi Poci**

**Nr. Tel 0672078390**

**Adresë emaili :alkoimpexal@gmail.com**

17.12 Detyrat kryesore të Drejtuesit Teknik janë si më poshtë:

- i. Ai është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktor për zbatimin e shërbimit të pastrimit në përputhje me kontratën dhe përmbajtjen e saj.
- ii. Mbajtjen e dokumentacionit teknik të detyrueshëm.
- iii. Ndjekjen e performancës së shërbimit të pastrimit në përputhje me plan-organizimin e miratuar dhe grafikun e shërbimit.

17.13 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik i shërbimit, Kontraktuesi duhet të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor dhe të ndjeke procedurën e parashikuar në pikën 3 të këtij.

17.14 Drejtuesi i ri Teknik duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktuesi duhet të propozojë dhe caktojë një Drejtues Teknik tjetër pas marrjes së miratimit të nevojshem nga Autoriteti Kontraktor.

## **Neni 18**

### **Vendndodhja**

18.1 Shërbimet duhet të kryhen në zonën e shërbimit të Kontratës siç është e përcaktuar në specifikimet teknike.

## **Neni 19**


### **Siguracioni i përgjegjësisë profesionale**

19.1 Kontraktuesi duhet të garantojë me Policë për sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin, për ta zhdëmtuar Autoritetin Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve.

19.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e shërbimeve që po sigurohen.

19.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e perfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

19.4 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do t'i dorëzohen mbikqyrësit për aprovim brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. Siguracioni duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktuesi nuk siguron çertifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata konsiderohet e anuluar. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zëvendësojë, të zgjasë periudhën e paraqitjes së çertifikatave të siguracionit ose të kryejë vetë



pagesën për policën e sigurimit të përgjegjësishë profesionale dhe të zbrisë koston e saj nga pagesa që i detyrohet Kontraktuesit.

19.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk mund të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Shkodër.

## Neni 20

### Mbeturina të rrezikshme

20.1 Përfaqësuesit e Kontraktuesit (të punësuarit e tij), kur konstatojnë praninë e çdo mbeturine të papranueshme brenda dhe jashtë kontenierit, duhet të lajmërojnë Autoritetin Kontraktor, Bashkinë Shkodër për këto mbeturina toksike, infektive ose të rrezikshme në mënyrë që bashkërisht të marrin masa për largimin e tyre. Në këto raste të dyja palët kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit.

## Neni 21

### Kontakti me publikun

21.1 Kontraktuesi duhet të mbajë një zyrë brenda juridiksionit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, me qëllim që të komunikojë me Autoritetin Kontraktor dhe publikun në përputhje me "Specifikimet teknike". Kontraktuesi është i detyruar të vendosë dhe komunikojë një numër telefoni dhe një adresë emaili për publikun. Këto kërkesa duhet ti komunikohen Autoritetit Kontraktor brenda 1 (një) muaji nga firmosja e Kontratës.

## Neni 22

### Edukimi publik mjedisor

22.1 Kontraktuesi duhet të zhvillojë një Program të Edukimit Publik Mjedisor të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Shkodres për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vendosur theksin në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e rrugëve dhe respektimin e orareve përkatëse. Ky program edukimi do të kryhet nga Kontraktuesi në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor Bashkinë Shkodër duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv.

22.2 Kontraktuesi duhet të hartojë dhe zbatojë çdo 6 muaj Programin e Edukimit Mjedisor për publikun, i cili do të përfshijë prodhimin dhe transmetimin i një spoti televiziv duke reflektuar përmbajtjen e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër. Kontraktuesi duhet të sigurojë transmetimin e spotit 5 herë në ditë në tre televizione të ndryshme që do të përcaktohen nga Autoriteti Kontraktor, për 7 ditë rradhazi.

22.3 Kontraktuesi duhet të prodhojë dhe të shpërndajë materialin informativ të shkruar një herë në tre muaj, me broshura ose fletë - palosje që pasqyrojnë idetë dhe formatin sipas idesë dhe përcaktimeve që do t'i jepen nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër.

22.4 Autoriteti Kontraktor i njofton Kontraktuesit kohën dhe afatin në të cilin do të realizohet dhe transmetohet spoti ose materiali informativ i shkruar, broshura ose fletë-palosja.

22.5 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, do të njoftojë me shkrim mbi detajet e realizimit të spotit dhe përzgjedhjen e televizionit në të cilët do të transmetohet spoti informativ, gjithashtu do të njoftojë me të shkruar detajet për konceptin dhe shpërndarjen e broshurës ose fletë-palosjes mbi edukimin publik mjedisor.





## Neni 23

### Taksat dhe tarifat

**23. Kontraktuesi është i detyruar të paguajë të gjitha taksat dhe tarifat vendore në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

## Neni 24

### Kontenierët, mjediset dhe paisjet

24.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër përcakton Pikat e Grumbullimit të Mbeturinave dhe numrin e kontenierëve për secilën pikë në zonën e Kontratës sipas preventivit, në specifikimet teknike, sipas listës së rrugëve dhe hartë, në përputhje me Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, Bashkia Shkodër 2017. Kontenierët do të mbeten pronë e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër.

24.2 Kontraktuesi do të marrë në dorëzim kontenieret nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, me anë të procesverbaleve të mbajtur e firmosur nga përfaqësuesit e secilës palë. Procesverbalet do të përmbajnë numrin e kontenierëve, pikat e vend grumbullimit ku do të vendosen kontenierët, gjendjen e kontenierëve, barkodin apo të dhëna të tjera që ndihmojnë në identifikimin e kontenierëve.

24.3 Kostot e transportit të kontenierëve nga magazina deri në pikat e përcaktuara të grumbullimit do të përballohen nga Kontraktuesi.

24.4 Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit dëmtohen për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsiper riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe duhet të sigurojë një vendpune dhe furnizimin me pjesët e këmbimit.

24.5 Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me Specifikimet Teknike.

24.6 Në rast të dëmtimit të kontenierit, Kontraktuesi do ta zëvendësojë atë menjëherë me kontenierin rrezervë të rregullt dhe të rregullojë kontenierin e demtuar.

24.7 Në rastin e humbjes ose vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve ose pagesën e vlerës së kontenierëve.

24.8 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, i përcakton Kontraktuesit vëndin e depozitimit të mbeturinave urbane. Kontraktuesi është përgjegjës për të siguruar dhe menaxhuar një vendodhje për inertet dhe mbetjet nga ndertimi. Kostoja për këtë shërbim do të mblidhet direkt nga prodhuesit e mbetjeve me një tarifë të përcaktuar në bashkepunim me Bashkinë në mënyrë që të merret konstoja e plotë.


24.9 Kontraktuesi, duhet të vendosë një numër rendor identifikimi për verifikim dhe shënimin e të dhënave nga monitoruesit për secilin kontenier ose një barkod, i cili do të mundësojë leximin e kodit IQ, në mënyrë që të dhënat për secilin kontenier, të lexohen dhe regjistrohen elektronikisht në sistemin elektronik të monitorimit.

24.10 Kontenierët gjatë gjithë periudhës së shërbimit, dhe në të gjithë zonën e Kontratës duhet të jenë me shenja të dukshme identifikuese për sigurinë gjatë natës.

## Neni 25

### Detyrime të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër

25.1 Autoriteti Kontraktor informon në mënyrë periodike banorët nëpërmjet lajmërimeve zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike rreth mbajtjes pastër të ambjentit.





25.2 Depozitimi i mbetjeve urbane dhe jo urbane do të kryhet gjatë 7 ditëve të javës. Autoriteti Kontraktor merr përsipër sistemimin e ambjentëve ku do të vendosen kontenerët për të mundësuar kryerjen e shërbimit.

25.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet të kryejë pagesën për shërbimet e kryera nga ana e Kontraktuesit në përputhje me kushtet e kësaj kontratë, pas zbritjes së penalteteve për mos ofrimin, ofrimin e keq dhe të pamjaftueshem të shërbimit.

## Neni 26

### Mbikqyrja e shërbimit

26.1 Mbikqyrësit e caktuar nga Autoriteti Kontraktor sipas procedurës standarte të veprimit për administrimin e shërbimit të pastrimit të miratuar, mbikqyrin drejt për drejt procesin e monitorimit nga monitoruesit e njësive administrative duke marrë në dorëzim cdo ditë formatet e raportimit të shërbimit të pastrimit dhe duke plotësuar dokumentacionin përkatës sipas Procedurës standarte .

26.2 Mbikqyrësi në zbatim të procedurës standarte plotëson procesverbalet dhe raportet ditore për punë kryer ose të pa kryer mbi cilësinë dhe masën e kryerjes së shërbimit.

26.3 Situacionet javore dhe mujore vendosen në sasi sipas cdo zeri shërbimi të shprehur në lekë në përputhje me raportimet ditore nga njësitë administrative process verbalet dhe raportet ditore/javore/mujore për shërbimin e kryer/të pa kryer dhe preventivin e kësaj kontratë.

26.4 Situacionet hartohen nga mbikqyrësi i Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër në prani të monitoruesve të njësive administrative caktuar nga Autoriteti kontraktor monitorues / administrator në zbatim të procedurës standarte të veprimit të miratuar. Kontrolli i kryerjes së shërbimit të pastrimit do të kryhet në vendin dhe kohën e përcaktuar në grafik sipas formateve të monitorim-raportimit.

26.5 Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proces-verbaleve dhe situacioneve javore të nënshkruara nga të dyja palët.

26.6 Situacionet që nuk pranohen të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit marrin vlerë dhe pa nënshkrimin e tij në këto raste:

a. Kur përfaqësuesi i Kontraktuesit nuk është prezent në kontrollin e punës sipas grafikut.


b. Drejtuesi Teknik i Kontraktuesit, pas njoftimit nga Mbikqyrësi i shërbimit, duhet të paraqesë prova lidhur me konstatimet e bërë nga Mbikqyrësi I shërbimit, në të kundërt konstatimet e Mbikqyrësit konsiderohen të mirëqëna.

26.7 Mbikqyrësit kur konstatojnë shërbim të pakryer/mospërbushje të detyrime kontraktuale, dokumenton rastet, informon njëkohësisht Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktuesin, dhe më pas vendos sanksionet e parashikuara në këtë kontratë.

## Neni 27

### Monitorimi i shërbimit

27.1 Autoritetit Kontaktor, në zbatim të Procedurës standarte të veprimit për administrimin e pastrimit të miratuar ka përcaktuar grupin e monitorimit duke filluar nga monitoruesit e njësive administrative monitoruesit administratorët deri tek mbikqyrësit e njësive të monitorimit të shërbimeve publike i cili bëhet i ditur kontraktuesit në zbatim të kësaj kontrate dhe procedurës standarte.



- 27.2 Grupi i monitorimit ka përgjegjësi për monitorimin e cilësisë dhe sasisë të shërbimit në territorin e mbuluar në zbatim të kësaj kontrate.
- 27.3 Grupi i monitorimit verifikon kryerjen e shërbimit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në prokurimin publik, raporton çdo ditë pranë autoritetit kontraktor dhe ndjek rregullat e përcaktuara në procedurën standarte.
- 27.4 Grupi i monitorimit identifikon nevojat specifike dhe bën propozimet tek autoriteti kontraktor.

## Neni 28

### Vlera totale e kontratës dhe çmimi i kontratës

“Vlera Totale e Kontratës”, nënkupton vlerën e pranuar nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe përmbushjen e Shërbimit.

“Çmim Kontratë”, nënkupton vlerën për tu paguar nga Autoriteti Kontraktues për zbatimin dhe përmbushjen nga ana e Kontraktuesit të shërbimeve dhe përmbushjes së të gjitha detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të lidhura me këtë Kontratë.

## Neni 29

### Afatet e pagesës

- 29.1 Pagesat e faturave të Kontraktuesit (certifikatat e pageses, situacionet), si edhe çdo pagesë paraprake, të paguhen në kohë siç specifikohet në Kontratë.
- 29.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhës së huaj do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i Kontratës për botim.
- 29.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në Kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues Bashkisë Shkodër me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalet dhe kopjet e saj, së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Shërbimet e kryera të cilat janë të listuar në Preventiv.
- 29.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në Kontratë, pagesa për Shërbimet bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë, bashkë me faturën tatimore.
- 29.5 Data e pagesës do të jetë data kur fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër.

## Neni 30

### Vonesa në bërjen e pagesës

30.1 Në rast të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, megjithëse Kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij me kushtet e Kontratës, Kontraktuesi do të këtë të drejtë të marrë detyrimet e prapambetura dhe kamatë vonesat përkatëse gjatë periudhes së vonesës në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

## Neni 31

### Ndalesat për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale



Kontraktuesi do t'i nënshtrohet ndalesave nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, si më poshtë vijon:

**1- Për mospërmbushje të detyrimit për “Mbledhje grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane”, kur konstatohen rastet:**

- a. **Kontenier i pa evaduar:** Përveç ndalesës për punë të pakryer sipas specifikimeve teknike dhe grafikut, kontraktuesi penalizohet me 2000 (dymijë) lekë për çdo kontenier të pa evaduar ditor.
- b. **Pikë Grumbullimi Mbeturinash e pa pastruar, mbetje në tokë, në një rreze deri në 5m nga të gjitha anët e pikës së grumbullimit:** Përveç ndalesës për punë të pakryer sipas specifikimeve teknike dhe grafikut, kontraktuesi penalizohet në masën 2000 (dymijë) lekë për çdo pikë grumbullimi mbetjesh të papastruar ditor.
- c. **Gjatë transportit të mbetjeve urbane, konstatohet që mjeti teknologjik ka rrjedhje vajrash apo lëngjesh nga kazani i makinerisë:** Kontraktuesi penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë për raste të konstatuara.

**2- Për mospërmbushje të detyrimit për “Dezifektim të pikës grumbullimit mbetjeve”, kur konstatohet se:**

- a. **Pikë Grumbullimi Mbetjesh e padizefektuar sipas grafikut:** Përveç ndalesës për punë të pakryer sipas specifikimeve teknike, kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesëmijë) lekë për pikë grumbullimi mbetjesh.

**3- Për mospërmbushje të detyrimit për “Menaxhim dhe mirëmbajtje kontenierësh” kur konstatohen rastet:**

- a. **Kontenier i pa larë:** Përveç ndalesës për punë të pakryer sipas specifikimeve teknike dhe grafikut, kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesëmijë) lekë për çdo kontenier të pa larë.
- b. **Kontenier i dëmtuar:** Përveç ndalesës për punë të pakryer sipas specifikimeve teknike, për çdo kontenier të dëmtuar, (rrota të hequra, deformime mekanike, lyerje me boje, etj.) i cili nuk rregullohet brenda 5-ditëve të lajmërimit nga Autoriteti Kontraktor, kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesëmijë) lekë për çdo kontenier në javë.

**4- Për mospërmbushje të detyrimit për “Depozitim i mbetjeve urbane në Landfill”, kur konstatohet:**

- a. **Mosdepozitim i mbetjeve urbane në landfill:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 500 000 (pesëqindmijë) lekë për çdo rast të konstatuar për hedhjen e mbeturinave në vend të pa autorizuar.

**5- Për mospërmbushje të detyrimit për “Edukim Publik Mjedisor”, kur konstatohet:**

- a. Mospërmbushje e detyrimit për edukimin publik mjedisor, sipas specifikimeve teknike, grafikut të përcaktuar, kontraktuesi do të penalizohet në masën 100 000 (njëqindmijë) lekë.

**6- Për mospërmbushje të detyrimit për “Pajisjen e punonjësve me uniforma sigurie dhe me mjetet e sigurimit teknik”, kur konstatohet se:**

- a. **Punonjësit nuk janë pajisur me uniforma dhe me mjetet e sigurimit teknik, sipas specifikimeve teknike:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 5000 (pesëmijë) lekë për çdo punonjës të konstatuar. Masa e penaltetit do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.



- 7- Kur konstatohet se kontraktuesi ka fikur sistemi GPS të mjeteve teknologjike, gjatë procesit të grumbullimit dhe transportimit për në landfilld të mbetjeve urbane dhe jo urbane si dhe mjetet e tjera teknologjike sipas specifikimeve teknike: Kontraktuesi do të penalizohet në masën 100 000 (njëqindmijë) lekë për çdo rast të konstatuar. Kontraktuesi do të gjobitet me të njëjten vlerë në rastin kur ai nuk ofron të dhenat e kerkuara për raportim, supervizim dhe llogaritje. Masa e penaltetit do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likujdim.
- 8- Për mospermbushje të detyrimit “të të pasurit në punë çdo ditë të numrit të mjeteve teknologjike”, kur konstatohet se:
- a. Nuk punojne çdo ditë të gjitha mjetet teknologjike sipas specifikimeve teknike dhe grafikeve të punëve, gje që sjell mosrespektim të frekuencave dhe të orareve të kryerjes se Shërbimeve, Kontraktuesi do të penalizohet në masen 50 000 (pesedhjete mijë) lek për çdo mjet të munguar.
- 9- Për mospermbushje të detyrimit “te prezences në punë të numrit të punonjësve” kur konstatohet se:
- a. Nuk eshte prezenca e plotë e punonjësve sipas specifikimeve dhe grafikeve ditore, Kontraktuesi do të penalizohet në masen 2000 (dymije) lek për çdo punonjës të munguar.
- 10- Penaltitetet dhe gjobat e aplikuara sipas kësaj Kontrate, nuk përjashtojnë masat e tjera penalizuese, që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga Legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 11- Çdo tentative ose praktike për të influencuar rezultatin e monitorimit të cilesise së Shërbimit dhe sasive me kercenim apo avantazhe ndaj grupit të monitorimit, familjes apo miqve do të penalizohet me 20 % ulje të preventivit mujor kur vendimi merret nga Bashkia. Këto praktika korruptive do t’i japin Bashkisë të drejtën për të ndalur Kontratën për një periudhe pre 6 muajsh dhe të iniciojë procedim penal.

### Neni 32

#### Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve

32.1 Nëse, pas datës së dorëzimit të ofertave, ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon në kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

### Neni 33

#### Forca Madhore

33.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara, ose ndërprerjen, për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa, në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas Kontratës, vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

33.2 Për qëllimet e këtij neni, “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, që të në



kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

33.3 Nëse ndodhet në situatë të Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues Bashkinë Shkodër. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

### Neni 34

#### Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit

34.1 Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e Kontratës sikurse përcaktohet në nenin 4.

34.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afateve të Kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontratës.

34.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

34.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

34.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera kur një gjë e tillë është në interesin publik. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor Bashkinë Shkodër, me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja e afatit do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

### Neni 35

#### Siguracioni i Punonjësve

35.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punonjësve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të paraqesë një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertën e tij. Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit kontraktor, çdo 6 (gjashtë) muaj, me datë 10 janar dhe 10 korrik, listën e të gjithë punonjësve të siguruar dhe të vërtetuar nga organi kompetent, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër në lidhje me punonjësit e Kontraktuesit.

### Neni 36

#### Negociatat dhe amendamentet

36.1 Palët nuk do të negociojnë amendime ose ndryshojnë asnjë pjesë të Kontratës, që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

36.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i Kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet tërësisht Kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

36.3 Çdo heqje dorë nga të drejtat pushtetore ose ndreqjet që mund të bëhen nga Palët sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar

i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe kushtet në të cilën ajo lëshohet.

### **Neni 37**

#### **Ndryshimi i porosisë**

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij të porosisë për shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

### **Neni 38**

#### **Ndërprerja për mosplotësim**

38.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë.
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

38.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mospërbushjedhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

### **Neni 39**

#### **Ndërprerja për shkak të falimentimit**

39.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë, nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

39.2 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

### **Neni 40**

#### **Ndërprerja për shkak të interesit publik**

40.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

40.2 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

40.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha shërbimet e kryera përpara ndërprerjes, dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### **Neni 41**

#### **Prishja e kontratës**

41.1 Në rast të shkeljeve të dispozitave të kësaj Kontratë, Pala shkelëse, është e detyruar t'i rregullojë ato. Palës shkelëse i ngarkohen shpenzimet e rregullimit të këtyre shkeljeve.



41.2 Me konstatimin e shkeljeve të kushteve të kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, i bën njoftim me shkrim Kontraktuesit për konstatimin dhe detyrimin e Kontraktuesit për rregullimin e tyre brenda 3 (tre) ditëve kalendarike.

41.3 Shkeljet sipas kushteve themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

- a. Nëse Kontraktuesi nuk kryen shërbimin e pastrimit në një pjesë të zonës së kontratës apo dhe të gjithë zonen së kontratës, për një periudhë të pandërprerë prej 7 (shtatë) ditësh me përjashtim të përcaktimeve në nenin 33 të kësaj Kontratë.
- b. Nëse masa e shërbimit të pakryer dhe e penalteteve të aplikuara tejkalon 15 % e vlerës vjetore të kontratës.
- c. Nëse Kontraktuesi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit.
- d. Nëse Kontraktuesi nuk ka në dispozicion dhe gjendje pune, apo ndryshon gjatë kohëzgjatjes së kontratës automjetet e kërkuara sipas Specifikimeve Teknike dhe të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertë pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër.

41.4 Nëse Kontrata për shkak të shkeljeve priset, atëherë Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër i lindin këto të drejta:

- a. E drejta për të deklaruar Kontratën të prishur, duke i dhënë Kontraktuesit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh që nga momenti i konstatimit të shkeljeve sipas kushteve themelore të kontratës, me argumentat përkatëse. Në qoftëse kontrata priset, Kontraktuesi detyrohet të kryejë Shërbimin e pastrimit për një periudhë prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e njoftimit të prishjes së Kontratës. Për këtë kohë, Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër është e detyruar të kryejë pagesën e Shërbimeve.
- b. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, ka të drejtën të sekuestrojë garancinë e kontratës të ngurtësuar në masën e përcaktuar në kontratë.
- c. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër ka të drejtën që t'i kërkojë dëmshpërblim Kontraktuesit në masën e dëmit të shkaktuar.

## Neni 42

### Transferimi i të Drejtave

42. Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër.

## Neni 43

### Sigurimi i kontratës

43.1 Përpara nënshkrimit të Kontratës, Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

43.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

43.3 Sigurimi i kontratës duhet t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

## Neni 44

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

44.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesi, duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

44.2 Nëse Palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas Kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 45

#### Përfaqësimi i Palëve

45.1 Çdo Palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përfaqësues, në emër të Palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e Palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e Kontratës.

a) Përfaqësuesi i **Autoritetit Kontraktor** Bashkia Shkodër, për ndjekjen e realizimit të Shërbimit dhe përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë:

**Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturaes**

cel/tel/fax \_\_\_\_\_

E-mail: [sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al](mailto:sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al)

b) Personi që do të jetë përfaqësues në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë

**Ing. Nazmi Poci**

**Nr. Tel 0672078390**

Adresë emaili :[alkoimpexal@gmail.com](mailto:alkoimpexal@gmail.com)

45.2 Secila Palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e Përfaqësuesit të Palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

45.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë, për të përfaqësuar Palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim, në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të Përfaqësuesit.


45.4 Administratori i Kontratës vë në dijeni Titullarin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, për çdo rast e çështje dhe nuk mund t'i drejtohet Kontraktuesit pa marrë më parë miratimin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

45.5 Në zbatim të VKM nr.914, dt.29.12.2014“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“e ndryshuar, kreu IX, neni 77, pika 4, ”Mbikqyerja e Kontratës”, në përfundim të kontratës, **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturaes** si struktura që do të jetë përgjegjëse, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës, do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe Kontraktuesit, me kërkesë të tij.

### Neni 46

#### Komunikimet

46.1 Mënyra e komunikimeve midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesit, është me shkrim dhe në mënyrë elektronike njëherësh. Të gjitha njoftimet të Palës do





ti drejtojnë njëra tjetrës të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht në zyrën e protokollit, me poste zyrtare ose poste elektronike duke iu adresuar palëve në mënyrën e mëposhtme:

a. Për Perfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, adresa e plotë e Institucionit ose adresa e postës elektronike.

b. Për Përfaqësuesin e Kontraktuesit, adresa e plotë e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike, të cilat Palët në çdo kohe ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim.

46.2 Njoftimet do të kenë efekte, me marrjen në dorëzim nga Palët.

#### Neni 47

##### Llogaritja e afateve

47. Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

#### Neni 48

##### Vlefshmëria e kontratës

48.1 Kjo Kontratë do të hartohet në gjashtë kopje origjinale, pesë për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin, dhe pasi u lexua dhe u pranua, do të firmoset nga Palët.

48.2 Kjo Kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

#### KUSHTET E VEÇANTA

##### Shërbimet–Procedurë e Hapur

Kushtet e Veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin e Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

#### Neni 1

##### Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetar i saj **Z.Bardh Spahia** që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

1.2 Kontraktues është **”Alko-Impex General Construcion”sh.p.k.** regjistruar ne regjistrin fillestar me nr.CN-202267-01-09 dhe leje profesionale te shoqerise kodi III.2.B nr.LN-1163-03-2016 date 10.03.2016 me vlefshmeri te lejes pa afat leshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit,Tregtise dhe Siper marrjes me seli te shoqerise:Rruga Reshit Petrela, Kompleksi Usluga-Tirane me NUIS K 91326028 I, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **z.Arber Abazi** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **”Kontraktuesi”**.

#### Neni 2

##### Sigurtimi i kontratës



- 2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së miratuar / korigjuar të ofertës) do të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës,  
**Nuk ka**
- 2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: **30 ditë pas nënshkrimit të palëve të procesverbalit perfundimtar të kryerjes së shërbimit.**

### **Neni 3**

#### **Fillimi i kontratës**

- 3.1 Zbatimi i Kontratës duhet të fillojë në datën që është përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontratë.
- 3.2 Specifikimet teknike, preventivi i ofertës fituese, grafiku vjetor i Shërbimeve, janë pjesë integrale e Kontratës dhe detyrime të Kontraktuesit.

### **Neni 4**

#### **Vendndodhja e shërbimeve**

4. Shërbimet do të kryhen në të gjithë zonën e Kontratës sipas objektit të kontratës dhe përcaktimeve të preventivit dhe raportit teknik.

### **Neni 5**

#### **Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

5. Perpara dates se nënshkrimit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkoder duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:
- Personin përgjegjes për ndjekjen e shërbimit.
  - Grafikun e shërbimit

### **Neni 6**

#### **Kërkesat e raportimit**

6. Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikun e shërbimit.

### **Neni 7**

#### **Kushtet e pagesës**

- 7.1 Pagesa për shërbimet, do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të situacionit mujor të shërbimit, dhe dokumentacioneve përkatëse.
- 7.2 Autoriteti Kontraktor siguron pagesat për Kontraktuesin për Shërbimet e kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas volumeve të kryera, duke u zbritur masa e volumeve të shërbimit të pakryer si dhe penalitetet e mundshme të mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të perfshihet vlera e T.V.SH.
- 7.3 Administratori i Kontratës bën miratimin e pagesës vetëm në rast se është plotësuar dokumentacioni i mëposhtëm bazuar në procedurën standarte të veprimit për administrimin e shërbimit të pastrimit :
- Raportin mujor përmbledhës të penaliteteve për punë të pa kryer nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit dhe drejtorja e shërbimeve publike (1 Origjinal);
  - Procesverbalin e konstatimit për punë të pa kryer firmosur nga të dy palët: nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit të shërbimeve publike dhe drejtorja e shërbimeve publike dhe Kontraktuesi (1 Origjinal);

- c. Vendimin për vlerën e shërbimit të pa kryer firmosur nga Autoriteti Kontraktor (1 Original) ;
- d. Situacionin mujor të ofrimit të shërbimit firmosur nga të dy palët: nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit të shërbimeve publike dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve në infrastrukturë dhe Kontraktuesi (1 Original);
- e. Nëse Situacioni i shërbimit dhe fatura perkatëse e tvsh do të jenë mujore atëherë ato do të mbajnë datën duke respektuar radhën e veprimeve sipas procedurës standarte të veprimit. Situacioni hartohet dhe miratohet mbasi të jetë miratuar. Proces verbali i konstatimit për punë të pa kryer, proces verbali i marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit dhe vendimi i Kryetares/it të Bashkisë për punë të pa kryer. Koha e përcaktuar për të përmbushur detyrat deri në njoftimin e operatorit të shërbimit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga ana e këtij të fundit është 03-05 të cdo muaji. Në rast mos rakordimi për situacionin e shërbimit mujor ose dokumentacionin mbështetës ku si rrjedhojë sjell vonesa në zbatim të këtij afati, komunikimi midis palëve realizohet me shkrim dhe afati nis ditën kur të dy palët bien dakord.
- f. Faturen/at tatimore të shërbimit, lëshuar nga Kontraktuesi (1 Original) e cila dorëzohet në formë elektronike ;
- g. Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit të shërbimeve publike dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve në infrastrukturë;  
Monedha e pagesës do të jetë: LEKE.

7.5 Në rast ndryshimi të llogarisë nga ana e Kontraktuesit ky i fundit është i detyruar të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Shkodër

### Neni 8

#### Zbritja e garancisë së kontratës

Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë. Nuk parashikohet zbritje e garancisë së Kontratës. Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR  
BASHKIA SHKODËR**

**Kryetar i Bashkisë  
Bardh SPAHIA**

**PER OPERATORIN EKONOMIK  
"Alko-Impex General Construcion"**

**Administratë Ligjor  
Arber ABAZI**